



QKRMT Qendra Kosovare për Rehabilitimin
e të Mbijetuarve të Torturës
KRCT The Kosova Rehabilitation
Center for Torture Victims

Konferenca Ndërkombëtare

Dokumentimi i dhunës seksuale në
konflikt: standardet dhe praktikat

Raporti pas konferencës

Përmbajtja

01

**Përmbledhja e
Konferencës**

03

**Pasqyra e
Programit**

05

Rekomandimet

06

**Pikat
kryesore nga
panelistët
kryesorë**



Përmbledhje e konferencës

Ky raport paraqet rezultatet e konferencës ndërkombëtare ‘Dokumentimi i dhunës seksuale në konflikt: standardet dhe praktikat’, i cili u organizua nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës në Prishtinë, më 18 tetor 2022. Kjo ishte një konferencë njëditore dhe me rreth 100 pjesëmarrës të pranishëm. Në audiencë të konferencës ishin zyrtarë të nivelit të lartë qeveritar, prokurorë, policë hetues, avokatë, anëtarë të Komisionit Qeveritar për njohjen e statusit të viktimave të dhunës seksuale, përfaqësues të ambasadave të Mbretërisë së Bashkuar, Zvicrës dhe Shteteve të Bashkuara në Kosovë, anëtarë të Akademisë, organizatave të shoqërisë civile që punojnë me të mbijetuarit dhe për të mbijetuarit e luftës në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi, rrjete, ekspertë të pavarur të drejtësisë tranzicionale dhe të mbijetuarë.

Gjatë konferencës, të pranishmit shkëmbyen opinione, mendime dhe sugjerime mbi nevojën dhe rëndësinë e dokumentimit të dhunës seksuale gjatë konflikteve.

Në hapje të kësaj konference, Drejtoresha Ekzekutive Feride Rushiti theksoi rëndësinë e dokumentimit të dhunës seksuale gjatë dhe pas luftës, sfidat për dokumentimin e këtij krimi të padukshëm dhe makabër, i cili është përdorur si armë lufte. Gjithashtu, ajo falënderoi të gjithë pjesëmarrësit e mbledhur nga Kolumbia e largët, Ukraina e cila po përballet me krime të kësaj natyre, organizatat rajonale nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia për të dëshmuar se krimet e dhunës seksuale si armë lufte mund të dokumentohen, si dhe për të dëshmuar rëndësinë se pse krimet e tilla duhet të dokumentohen.

Panelistët kryesorë të konferencës ishin Feride Rushiti, themeluese dhe Drejtoreshë Ekzekutive e QKRMT-së, Albulena Haxhiu – Ministre e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, Thomas Kolly – Ambasador i Zvicrës në Republikën e Kosovës, Fatmire Haliti – Menaxhere e Projektit të Dokumentimit në QKRMT dhe Jule Krüger – Konsulente dhe Hulumtuese e të Dhënave për të Drejtat e Njeriut, dhe Këshilltare Kërkimore për Dëshmi Sasiore dhe Analiza në Amnesty International.

Gjatë ditës, pjesëmarrësit e konferencës patën mundësinë të marrin pjesë dhe të diskutojnë tema të rëndësishme në sesione të ndryshme. Në pjesën e parë të konferencës u diskutua për procesin e dokumentimit dhe Manualin për dokumentimin e dhunës seksuale lidhur me konfliktin (Fatmire Haliti), si dhe praktikat ndërkombëtare të dokumentimit dhe hulumtimit të dhunës seksuale në konflikt (Jule Krüger).

Ndërsa pjesa e dytë e konferencës u nda në dy panele diskutimi. Në panelin e parë, panelistët Irina Dovgan dhe Volodymyr Shcherbachenko nga SEMA në Ukrainë dhe “Pilar Rueda” dhe Angela Maria Escobar nga SEMA në Kolumbi ndanë përvojat dhe njohuritë e tyre rreth praktikave ndërkombëtare të dokumentimit të dhunës seksuale në konflikt. Në panelin e dytë u diskutua më shumë perspektiva rajonale e dokumentimit nga panelistet Leonora Selmani nga Komisioni Qeveritar (Kosovë), Sabiha Husic nga “Medica Zanica” (Bosnje dhe Hercegovinë) dhe Sanja Pavlovic nga Qendra Autonome e Grave (Serbi) ku panelistet përshkruan praktikën dhe statusin e dokumentimit në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi duke theksuar rëndësinë e dokumentimit të krimeve të dhunës seksuale gjatë luftës me fokus në sfidat, kontekstin, kulturën, mentalitetin dhe vlerat e tjera të rëndësishme të shoqërisë.

Në përfundim të konferencës, rekomandimet e dala nga diskutimet e konferencës u prezantuan dhe iu shpërndanë pjesëmarrësve.

PASQYRA E PROGRAMIT

Historiku: Projekti i dokumentimit të dhunës seksuale në konflikt

Dokumentimi i dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë është një projekt i iniciuar dhe zbatuar nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, me qëllim të krijimit të një regjistri të gjerë dhe të detajuar të rasteve të dhunës seksuale gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë. Projekti është duke u zbatuar në bashkëpunim me organizata partnere si: Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave, Medica Kosova dhe Medica Gjakova.

Dokumentimi është duke u realizuar përmes përdorimit të një pyetësori të zhvilluar dhe hartuar nga QKRMT-ja ekskluzivisht për qëllime të dokumentimit. Pyetësori përmban 83 pika dhe është i ndarë në 8 seksione me pyetje që mbulojnë të dhënat e incidentit, metodat e përdhunimit, pasojat shëndetësore, shërbimet e ofruara, qasjen në drejtësi dhe reparacionet.

Gjithashtu, QKRMT-ja është duke hartuar një manual që bazohet në përvojën e saj dhe në kontekstin e Kosovës në lidhje me dokumentimin e dhunës seksuale gjatë luftës, i cili synon të shërbejë si një mjet për shkëmbimin e mësimëve të nxjerra në këtë proces dhe prezantimin e disa udhëzimeve për të tjerët që do të angazhohen në dokumentimin e dhunës seksuale gjatë konflikteve.

Objektivat

Programi i konferencës kishte për qëllim përmbushjen e këtyre objektivave:

- të theksoj rëndësinë e dokumentimit të dhunës seksuale në konflikt si krim lufte;
- të evidentojë rolin e dokumentimit në procesin e ballafaqimit me të kaluarën;

- ♦ të prezantojë Manualin për Dokumentimin e Dhunës Seksuale në Konflikt duke u bazuar në dokumentimin e rasteve të realizuara gjatë viteve 2019 - 2022 në Kosovë;
- ♦ të diskutojë dhe shkëmbej standardet dhe praktikat ndërkombëtare dhe rajonale të procesit të dokumentimit.

Përfundimi

Në përgjithësi, objektivat e konferencës u arritën dhe u diskutuan gjerësisht. Ekziston me të vërtetë një nevojë urgjente për veprim më të rreptë dhe konkret që institucionet, shoqëria civile dhe palët e tjera të interesit duhet t'i përmbahen dhe të kontribuojnë në dokumentimin dhe suksesin e tij në vend që thjesht të pranojnë realitetet e stigmës dhe paragjytimeve që i rrethojnë të mbijetuarit dhe i pengojnë ata të flasin për të dhe të dokumentojnë të kaluarën e tyre të dhimbshme.

Në konkluzionet e saj, konferenca argumentoi edhe një herë se pse dokumentimi është i rëndësishëm.

Dokumentimi do të shërbejë si parakusht për:

- arritjen e njohjes ligjore dhe sociale të të mbijetuarve të dhunës seksuale në konflikt;
- t'u mundësuar të mbijetuarve të përfitojnë nga skema e reparacionit;
- arritjen e drejtësisë për të mbijetuarit;
- njohjen e vuajtjeve dhe dhimbjeve të të mbijetuarve dhe luftimin e stigmës që i rrethon;
- njohjen e të vërtetës dhe luftimin e të gjithë atyre që i mohojnë krimet;
- zhvillimin e programeve të rehabilitimit dhe riintegrimi për të mbijetuarit;
- edukimin e brezit të ri dhe rritjes së ndërgjegjësimit në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar;
- të ndihmuar dhe nxitur kërkimin akademik mbi dhunën seksuale në konflikt si armë lufte;
- parandalimin e shfaqjes së dhunës seksuale në konflikte të tjera në mbarë botën.

Rekomandimet

Konferenca nxori rekomandime për të gjitha palët e përfshira në procesin e dokumentimit të dhunës seksuale në konflikt që:

01

Të dokumentojnë krimet e dhunës seksuale sa më shpejt që është e mundur nga koha kur kanë ndodhur krimet

02

Të posedojnë sa më shumë prova fizike, prova dokumentare, prova nga dëshmitë si dhe prova digjitale (raporte, fotografi, apo edhe prova mjeko-ligjore kur është e mundur etj.). Shpesh të gjitha këto përdoren në mënyrë plotësuese

03

Të ofrojnë mbështetje psikologjike për të mbijetuarit që tregojnë historitë e tyre vazhdimisht, domethënë në të gjitha fazat e dokumentimit

04

Të mbështesin të mbijetuarit në procesin e dokumentimit përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe holistike

05

Të përgatisin të gjitha procedurat paraprake:

- Informimi i të mbijetuarve për qëllimet e dokumentimit;
- Zhvillimi i pyetësorëve;
- Realizimi i intervistave;
- Formulari i pëlqimit;
- Përpunimi i të dhënave;
- Konfidencialiteti dhe publikimi i të dhënave;
- Ruajtja e të dhënave;
- Të dhëna meta
- Hartimi i një Manuali të përgjithshëm (ku përfshihen të gjitha fazat dhe hapat e dokumentimit) dhe kontekstualizimi i tij.

06

Të forcojnë bashkëpunimin me organizatat dhe palët e tjera institucionale, përfshirë institucionet akademike

07

Të ruajnë zinxhirin e provave (kujdestari) - dokumentimi kronologjik që regjistron strukturën e ruajtjes, kontrollit, transferimit, analizës dhe sistemimit të materialeve, duke përfshirë provat fizike ose elektronike

Konferenca Ndërkombëtare: Dokumentimi i dhunës seksuale në konflikt u organizua në kuadër të projektit “Përmirësimi i përpjekjeve për drejtësinë tranzicionale në Kosovë përmes dokumentimit të dhunës seksuale gjatë luftës”, i mbështetur nga Ambasada Zvicerane në Kosovë. Kontributi i organizatave në këtë konferencë dhe procesi i dokumentimi është mbështetur nga Ambasada Zvicerane, BMZ, Medica Mondiale dhe Ambasada Britanike në Kosovë.

Pikat kryesore | Panelistët kryesorë



Vetëm duke dokumentuar krimet e dhunës seksuale në konflikt, ne mund të arrijmë drejtësi për viktimat, të mbrojmë të drejtat e tyre, t'u mundësojmë atyre të përfitojnë nga programet e rehabilitimit dhe skemat e reparacioneve, si dhe të luftojmë stigmën dhe të edukojmë gjenerata të reja.

Feride Rushiti - Themeluese dhe Drejtoreshë Ekzekutive e QKRMT-së



Institucionet tona i kanë njohur viktimat e dhunës seksuale nga koha e luftës shumë vonë dhe në një shoqëri me mentalitet patriarkal, në radhë të parë nuk kanë qenë e lehtë për viktimat. Ukraina nuk duhet të ndjekë shembullin e dokumentimit në Kosovë në kuptimin e vonësive kohore, por ta marrë Kosovën si shembull të mirë në dokumentim për nga aspekti i përmbajtjes. Gjithashtu, në Kosovë, shoqëria civile është shembull i shkëlqyer i kontributit në dokumentimin e krimeve, ku nevojat dhe interesat e viktimave kanë qenë gjithmonë në qendër.

Albulena Haxhiu - Ministre e Drejtësisë e Republikës së Kosovës




Dokumentimi ka të bëjë me vërtetimin e fakteve dhe kjo nënkupton bazën për të mos harruar dhe për të mos mohuar. Pra, dokumentimi u jep zë viktimave dhe të mbijetuarve. Gjithashtu, mbështetja psikologjike është thelbësore për të mbijetuarit. Duke dhënë dëshmi që janë të dhimbshme, rreziku i rikthimit të traumës është shumë i lartë. Tutje, luftimi i stigmatizimit duhet të bëhet në të gjitha nivelet, në familje, komunitet dhe shoqëri, e veçanërisht duke pasur parasysh sistemin patriarkal të vlerave, i cili është i përhapur në mbarë botën. Dhe për fund, shkëmbimi i ekspertizës së ndërtuar ndër vite nga organizatat e shoqërisë civile, siç është QKRMT-ja, është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe në të njëjtën kohë bashkëpunimi me institucionet si Komisioni Qeveritar për njohjen e statusit të të mbijetuarve.

Thomas Kolly - Ambasador i Zvicrës në Republikën e Kosovës



Në nivel kombëtar, nuk ka pasur një dokumentim gjithëpërfshirës të rasteve të dhunës seksuale të ndodhura gjatë luftës në Kosovë. Në këtë kontekst, në vitin 2019 QKRMT-ja së bashku me organizata të tjera të shoqërisë civile ka filluar procesin e dokumentimit të krimeve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Dhe, funksionalizimi i një sistemi të qëndrueshëm të dokumentimit, i krijuar nga QKRMT-ja, ka pasur sukses dhe rezultate dhe kjo ka qenë një shtysë për ne që të kthejmë përvojën tonë në një instrument udhëzues që do t'u shërbente të tjerëve, ku ne kemi hartuar një Manual për dokumentimin e krimeve të dhunës seksuale në konflikt.

Fatmire Haliti - Menaxhere e projektit të dokumentimit në QKRMT



Partneriteti strategjik midis personave të angazhuar në dokumentim dhe i akademikëve është mjaft i rëndësishëm. QKRMT është një shembull ku shërbimet përkatëse janë të përfshira në procesin e dokumentimit. Dhe këtu ekziston vërtet një mundësi që studiuesit të përmbushin gjithashtu standardin e shtimit të vlerës dhe përfitimit të të mbijetuarve, sepse projekti lokal do të avokojë për të drejtat e të mbijetuarve dhe gjithashtu do të kujdeset për mirëqenien e tyre duke ofruar shërbime mbështetëse. Gjithashtu, OShC-të dhe personat e angazhuar në dokumentim mund të kenë bashkëpunim me ekspertë në faza të ndryshme të dokumentimit dhe mund të zhvillojnë kapacitetet e organizatës lokale si dhe të kryejnë hulumtime për procesin e dokumentimit me qëllim të sigurimit të informatave për praktikën aktuale. Përveç kësaj, ky partneritet forcon zërin e të mbijetuarve duke shpërndarë njohuritë e projektit brenda komunitetit akademik për të avancuar shkencën globale dhe diskursin e politikave për dokumentimin e dhunës seksuale në konflikt.

Jule Krüger - Konsulente dhe Hulamtuese e të Dhënave për të Drejtat e Njeriut, dhe Këshilltare Hulamtuese për Dëshmi Sasiore dhe Analiza në Amnesty International

Pikat kryesore | Panelistët e panelit të 1-rë



Konferenca në të cilën kisha nderin të merrja pjesë ishte përgatitur në një nivel të lartë. Kam dëgjuar shumë gjëra të rëndësishme. Faleminderit për mundësinë për të marrë përvojën që keni fituar. Faleminderit për mundësinë për të treguar se çfarë po ndodh në Ukrainë. Gjatë 7 muajve të fundit, unë kam dokumentuar krimet e ushtrisë ruse në territorin e pushtuar të rajonit të Kievit. Gjatë kësaj kohe kam hasur në shumë raste të përdhunimit të grave. Disa raste u shoqëruan me një egërsi të tmerrshme. Sipas sondazhit tim, 4-5% e grave u përdhuan në secilin fshat të pushtuar nga rusët. Prandaj theksova se dokumentimi i krimeve është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm. Kjo do të ofrojë një mundësi për të sjell kriminelët para drejtësisë.

Irina Dovgan - SEMA, Ukrainë



E vlerësoj këtë mundësi për të shkëmbyer përvojën si dhe për të mësuar nga përpjekjet e gjera të QKRMT-së në luftën për të drejtat e të mbijetuarve. Mundësia për të shkëmbyer informata për situatën në Ukrainë ishte gjithashtu shumë e rëndësishme për mua. Unë jam thellësisht i impresionuar nga mbështetja e popullit dhe e të gjitha degëve të pushtetit të Kosovës për vendin tonë. E vlerësoj këtë dhe do ta mbajë mend.

Volodymyr Shcherbachenko - EUCCI dhe SEMA, Ukrainë



Besimi është një nga parakushtet kryesore në procesin e dokumentimit. Në Kolumbi ne krijuam seancat e denoncimit kolektiv ku viktimat mund të denoncojnë në një mjedis të sigurt fizik dhe emocional. Ky model udhëhiqet nga vetë viktimat dhe ne kemi mbajtur tridhjetë konferenca deri më tani, ku kanë raportuar 1527 viktima që më parë nuk kanë dashur t'i raportojnë nga frika. Më pas kemi dokumentuar më shumë se 650 raste dhe pastaj e kemi kuptuar se duhet t'i sistemojmë informatat.

Angela Maria Escobar - SEMA, Kolumbi



Në Kolumbi, viktimat që e bëjnë dokumentimin bëhen ndërmjetëse midis viktimave dhe sistemit të drejtësisë dhe kjo është shumë e rëndësishme sepse kjo është mënyra për të ndërtuar besimin. Një tjetër gjë që është gjithashtu shumë e rëndësishme është se dokumentimi i bërë nga viktimat ndihmon në parandalimin e ri-viktimizimit dhe parandalimin e stigmatizimit që është shumë i shpeshtë nga ana e drejtësisë në çdo pjesë të botës – nga drejtësia e rregullt si dhe nga drejtësia tranzicionale. Diçka që është shumë e rëndësishme është fakti se dokumentimi i dhunës seksuale kërkon një qasje gjinore.

Pilar Rueda - SEMA, Kolumbi

Pikat kryesore | Panelistët e panelit të 2-të



Në procesin e dokumentimit, sfidat kryesore janë mungesa e dokumentacionit dhe ngarkesa emocionale gjatë punës për njohjen e statusit ligjor të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Historia narrative është pjesa më e rëndësishme e procesit të aplikimit dhe është shumë e vështirë për të mbijetuarit të përshkruajnë historinë. Me një dokumentim të duhur, do të ishte shumë më e lehtë dhe procesi i njohjes do të ishte më pak të traumatizues.

Leonora Selmani - Komisioni Qeveritar (NJVSPDHLÇK), Kosovë



Dokumentimi i krimeve të dhunës seksuale të ndodhura gjatë luftës në Bosnje dhe Hercegovinë është zhvilluar vetvetiu ndër vite duke mbledhur çfarëdo lloj dokumentacioni dhe prove. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e dokumentimit të dhunës seksuale gjatë luftës, është thelbësore të kemi një manual, udhëzues që përcakton parimet dhe kriteret bazë për dokumentimin e krimit të dhunës seksuale duke marrë parasysh edhe rrethanat specifike, kulturën dhe mentalitetin e shoqërisë.

Sabiha Husić - Medica Zenica, Bosnje dhe Hercegovinë



Institucionet publike në Serbi nuk e njohin statusin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës as ligjërisht dhe as me asnjë lloj iniciative. Krimet e dhunës seksuale gjatë luftës janë injoruar plotësisht nga autoritetet zyrtare dhe vetëm organizatat e shoqërisë civile e kanë ngritur zërin në mbështetje të të drejtave të këtij grupi të cënueshëm.

Sanja Pavlović - Qendra Autonome e Grave, Serbi
